



2-180/9428
N. 10
Data 27.10.2022

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E JUNIKUT MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

Kuvendi Komunal
02/01/22
Datë: 21.10.2022
Junik

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016, për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, neni 8, paragrafi. 1 përzgjedhjen e anëtareve në komitetin konsultativ Kuvendi i komunës shpall konkurs publik:

KONKURS PUBLIK

Institucioni:
Titulli i vendit të punës:

Kuvendi komunal në Junik
Anëtarë i komitetit konsultativ

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Komitetet konsultative mund të dorëzojnë propozime nga fushë veprimtarit e ndryshme në pajtim me statutin e komunës;
- Dhënie e propozimeve për rregullore të ndryshme;
- Hulumtime të ndryshme;
- Japin mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga Kryetari komunës, komitetet e përhershme apo kuvendi i komunës në fushën përkatëse;
- Paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytarëve të Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës;
- Japin propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.

Shkollimi i kërkuar: Diplomë Universitare e dëshirueshme, e obliguar diploma e shkollës së mesme.

Aftësi / përvojë dhe attribute tjera që kërkojnë: Të ketë aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhimin e punëve, shkathtësi kompjuterike, (Word, Excel).

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejte aplikimi kanë të gjithë banoret e komunës së Junikut, të moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, kanë përgatitjen e nevojshme shkollore dhe aftësi fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në ndërtesën e Komunës pranë: Zyrës së Kryetarit të Komunës.

Konkursi mbetet i hapur 15 dite nga dita e publikimit nga data: 21.10.2022.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatet e interesuar të komunës së Junikut.

Aplikacionit i bashkëngjitet: Kopja e diplomës mbi kualifikimin, Kopja e Letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, Ekstraktin e lindjes.

Kandidatet të cilët përzgjidhen në listën e ngushte për interviste njoftohen: Ueb faqen e komunës, njoftimin publik dhe në telefon në afat ligjor për procedurat e intervistimit.

Kuvendi i Komunës së Junikut:

Shpejtim Gacaferi

